

VENDIM
Nr. 829, datë 28.12.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 500, DATË 24.8.2023, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI I GJUE TISË, PËR
QËLLIME SHKEN CORE PASVAKSINALE, TË KAFSHËVE TË VAKSINUARA, NË
KUADËR TË PROJEKTIT IPA 2020, KONTROLLIN DHE ÇRRËNJOSJEN E
SËMUNDJES SË TËRBIMIT – FAZA IV”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “b”, e 2, të nenit 4, të ligjit nr. 60/2022, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2, të vendimit nr. 500, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, pas fjalëve “... dhjetor 2023 ...” shtohen “..., si dhe janar 2024 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, Drejtoria e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama